



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 72, Datë 10.03.2026

MBI

DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET MARRËVESHJES SIGURUESE) TË ASETVE FIKSE TË SHOQËRISË “NOVA SOLAR SYSTEM” SH.P.K., SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ “RAIFFEISEN BANK” SH.A.

Në mbështetje të neneve 16, 20, gërma “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, gërma “b”, 6, 7 dhe 8 të Rregullores së procedurave të transferimit të asetve nga të licensuarit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.07.2016; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe pikave 1.3 dhe 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.03.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 843 prot., datë 06.03.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të asetve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.,

Konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënie e autorizimit për shoqërinë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për Marrjen e Autorizimit

- Shoqëria “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k., është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 242, datë 03.08.2023.
- Me shkresën nr. 62/1 prot., datë 19.01.2026 shoqëria ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e asetve të saj, si mjet (barrë siguruese) për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.

2. Shqyrtimi i Kërkesës dhe Kërkesa për Dokumentacion Plotësues

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 29, datë 04.02.2026, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë.
- ERE me shkresën nr. 54/6 prot., datë 11.02.2026 dhe e-mailin e datës 23.02.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës dhe i ka bërë me dije dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në këtë aplikim. Gjithashtu në lidhje me vendimin e bordit të ERE-s nr. 251/2025, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nëpërmjet shkresës me nr. 585 prot., datë 10.02.2026.

3. Dorëzimi i Dokumentacionit Plotësues

- Me e-mailin e datës 25.02.2026 dhe shkresën nr. 62/6, datë 02.03.2026 shoqëria ka përcjellë të plotë dokumentacionin/informacionin e munguar në këtë aplikim.

4. Përfundime dhe Kërkesa të tjera për Dhënien e Autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 4, 6, 7 dhe 8, të “*Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit*”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, si vijon:
- **Neni 4, gërma b** – Për transferimin e aseteve të të licensuarve me kapacitet të instaluar nën 1 MW, nuk ka nevojë për miratimin e ERE. Për të gjithë të licensuarit e tjerë *do të kërkohej miratimi i ERE-s për transferim të aseteve kur vlera e asetit që kërkohej të transferohej është më e madhe se 150.000.000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë.*

5. Plotësimi i Kërkesës sipas nenit 7:

- **Pika 1** - Janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi kërkesën për transferim, ndër të tjera si më poshtë vijon:
 - **Gërma “a”**- Është depozituar Ekstrakti historik i shoqërisë, i vlefshëm brenda afatit ligjor;
 - **Gërma “b”** - Është plotësuar informacioni mbi veprimtarinë e licensuar;
 - **Gërma “c”** - Është plotësuar informacioni mbi gjendjen financiare të kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efekti i pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve;
 - **Gërma “d”** - Është bërë një përshkrim i kandidatit;
 - **Gërma “e”, “f” dhe “g”** - Arsytet e kërkesës, efektet në aktivitetin e licensuar dhe furnizimin e klientëve;
 - **Gërma “h”** - Janë depozituar Kontratat/Marrëveshjet përkatëse; -
 - *Kontratë Kredie me nr. 7303 rep., nr. 3488 kol., datë 06.10.2023, nënshkruar nga palët, që do të përdoret nga kredimarrësi për financimin në lidhje me investimin në projektin për ndërtimin, instalimin dhe vënien në punë të parkut fotovoltai 50 MW si dhe mbylljen e detyrimeve të shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k..*
 - *Kontratë Kredie nr. 10975 rep., nr. 4604 kol., datë 19.12.2025, nënshkruar nga palët, që do të përdoret për të financuar kredimarrësin për ndërtimin/instalimin e kapaciteteve magazinuese të energjisë elektrike në bateri me qëllim magazinimin e energjisë elektrike së prodhuar nga parku fotovoltai 50 MW.*
 - *Marrëveshje Siguruese nr. 10979 rep., nr. 4608 kol., datë 19.12.2025, me anë të të cilës është rënë dakord të vendoset në favor të barrëmarrësit asetet fikse të shoqërisë.*
 - **Gërma “i”** - Deklarata e kredihënësit për garantimin e vazhdimësisë së aktivitetit;
 - **Gërma “j”** - Deklarata dhe vërtetimi për mungesë transferimesh të mëparshme mbi asetet fikse.
- **Pika 3** - Është plotësuar informacioni i kërkuar në këtë pikë që lidhet me detyrimet me të cilat ngarkohet subjekti për shkak të marrëveshjes së koncesionit në pjesët që transferojnë tek përfutuesi përfshirë edhe informimin e Autoriteti Shtetëror, në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve.
- **Pika 4** - Kërkesa për aplikim është nënshkruar nga administratori i shoqërisë, ndërsa

dokumentet e tjera shoqëruese të këtij aplikimi janë nënshkruar nga administratori dhe/ose personat e autorizuar sipas rastit.

Pika 6 - Shoqëria ka bërë me dije se kërkon që dokumentacioni i këtij aplikimi të mos jetë i hapur për publikun.

- Pavarësisht kërkesës së shoqërisë për konfidencialitetin tërësor të dosjes, ERE, në zbatim të rregullave të mësipërme dhe “*Rregullores për mbrojtjen e informacionit konfidencial*”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 65, datë 26.03.2018, ka kryer shqyrtimin e dokumentacionit për të identifikuar konkretisht pjesët që justifikojnë trajtimin si konfidencial, duke zbatuar parimin e kufizimit proporcional (pra, klasifikim vetëm për ato pjesë ku ka bazë ligjore dhe nevojë reale për mbrojtje).
- Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar, duke qenë se përmbajnë të dhëna identifikuese të personave fizikë, si dhe informacione të aktivitetit tregtar, justifikojnë trajtimin si konfidencial, dokumentacioni si vijon:
 1. Shkresa e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. e datës 19.01.2026, kërkesë për dhënien a autorizimit për vendosjen e aseteve si barrë siguruese. (Do të konsiderohen konfidenciale të dhënat personale të administratorit, si dhe informacione të aktivitetit tregtar të shoqërisë).
 2. Deklarata e bankës “Raiffeisen Bank” sh.a. e datës 26.02.2026, mbi përshkrimin e aktivitetit të saj. (Ky dokument do të konsiderohet si konfidencial duke qenë se përmban informacione të aktivitetit tregtar të bankës dhe të dhëna sensitive që mund të konsiderohen si sekret tregtar).
 3. Kontrata e Kredisë Bankare nr. 7303 rep., nr. 3488 kol., datë 06.10.2023 dhe Kontrata e Kredisë Bankare me nr. 10975 rep., nr. 4604 kol., datë 19.12.2025 (Këto dokumente do të konsiderohen si konfidencial, duke qenë se ajo përmban termat e një marrëdhënieje garancie dhe mund të përfshijë: kushte financimi, detaje të kontratave të kredisë, risk kreditor, klauzola sigurimi, detyrime të palëve, të cilat janë të dhëna me natyrë ekonomike/kontraktuale që mund të dëmtojnë interesat e subjektit/palëve të treta nëse publikohen).
- Nga ana tjetër, do të konsiderohen dhe trajtohen si jokonfidencial, për arsye se janë dokumente me karakter deklarativ/informues dhe/ose janë të depozituara apo të aksesueshme pranë institucioneve publike kompetente, dokumentacioni si vijon:
 1. Ekstrakti i regjistrimit tregtar i shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. (Ky dokument do të konsiderohet si jokonfidencial, në rrethanat kur është i publikuar dhe i aksesueshëm pranë institucioneve publike kompetente, në rastin konkret Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB);
 2. Marrëveshje siguruese nr. 10979 rep., nr. 4608 kol., datë 19.12.2025. (Marrëveshja Siguruese do të konsiderohet jokonfidenciale (pasi këto marrëveshje publikohen në QKB), por me redaktim selektiv të elementeve që përbëjnë të dhëna financiare sensitive dhe të dhëna personale.
 3. Deklarata e administratorit e 27.02.2026, ku shprehet se nuk janë kryer transferime të aseteve të shoqërisë më herët, si dhe Shkresa e shoqërisë me nr. 129 prot., datë 17.02.2026, për plotësimin e dokumentacionit të munguar (Këto dokumente përbëjnë akte të brendshme deklarative, dhe nuk përmbajnë në vetvete sekret tregtar apo informacion financiar të ndjeshëm, ndaj konsiderohen dokumente me natyrë jokonfidenciale, por me redaktim selektiv të elementeve që përbëjnë të dhëna personale).

6. Kushtet e Vendosura për Dhënien e Autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të aseteve fikse të saj (sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi), si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a., nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë **autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.**
- Për shkak të natyrës që ka vendosja e një mjeti të tillë mbi asetet e shoqërisë për garantimin e detyrimit përkatës nga i licencuari, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi asetet e saj ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet marrëveshjes siguruese) të aseteve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a. (për kontratat e kredive nr. 7303 rep., nr. 3488 kol., datë 06.10.2023 dhe nr. 10975 rep., nr. 4604 kol., datë 19.12.2025, si dhe nga marrëveshjen siguruese nr. 10979 rep., nr. 4608 kol., datë 19.12.2025). (lista e aseteve bashkëlidhur)
2. Dhënia e autorizimit sipas përcaktimeve të pikës 1 nuk e çliron shoqërinë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
3. Shoqëria “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi asetet e paluajtshme të saj që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar, ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm, si dhe në rast të çdo ndryshimi në këtë marrëveshje, përfshirë transferimin te të tretët .
4. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se shoqëria dokumenton heqjen e barrës siguruese të radhës së parë të vendosur mbi asetet e saj, apo depozitohet ndonjë dokument i ndryshëm nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI

ANEKS 1

“AKTIVET AFATGJATA MATERIALE ME VLERË FILLESTARE 30.11.2025”

- Toka, me vlerë 127,840,738 lekë;
- Mjete transporti, me vlerë 2,767,560 lekë;
- Paisje informatike, me vlerë 452,761 lekë;
- Të tjera, me vlerë 44,158 lekë;
- Nënstacioni Hoxharë, me vlerë 323,078,727 lekë;
- Main Station, me vlerë 135,723,489 lekë;
- Panele fotovoltaike, me vlerë 1,317,747,626 lekë;
- Inverterat, me vlerë 169,467,386 lekë;
- F. V kamera/ndriçim, me vlerë 77,247,740 lekë;
- Kabina Box, me vlerë 514,948,222 lekë;
- Rrethim kantieri, me vlerë 69,013,267 lekë;
- Punime skarifikimi, me vlerë 154,622,626 lekë;
- Konstruksioni paneleve, me vlerë 491,630,115 lekë.

Vlera totale rezulton 3,384,584,414 (tre miliard e treqind e tetëdhjetë e katër milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e katërmëdhjetë) lekë.